

GJENDJA DHE PERSPEKTIVA NË STUDIMIN E GJËEGJËZËS SI FORMË E SHKURTËR E LETËRSISË GOJORE

POSITION AND PERSPECTIVE OF THE RIDDLE STUDIES AS A SHORT FORM IN ORAL LITERATURE

LEONTINA GEGA-MUSA

Instituti Albanologjik-Prishtinë, rr. Eqrem Çabej nn, Prishtinë

Email: leontina_gm@hotmail.com

Abstract

Composition of oral literary has cultivated its genres, which in panel of Albanian folklore has been studied, but not in equal mass. Riddle like a short form of this composition together with myth, fables, fairytales, and proverbs are grouped in types of early thinkings, which were created and spread in many cultures around the world. Presence of riddles in our oral composition is an evidence of one old mythological, spiritual and philosophical culture. This form, eventhough short one, in its perception carries authentical, philosophical, and utilitarian literary values. These polyvalent values of riddles have been transmited in continuity in composition of oral literature, which like a component part of folklore is irreplaceable determinant of our ethnic identity and vital expression of this tradition. This tradition, during cultural evolution is always in movement, growing and changeing accorrding to the level of cultural evolution of its representatives. Hence, research and study of tradition is necessary continnonsly. Riddle is in focus of my investigation for a period of time. Hence, in this commentary I will present circumstance and perspective of the study of riddle like a short form of oral literature, within albanian folklore, by determining it with its essential characteristics.

Key words: Riddle, circumstance, study, oral literary composition, perspective.

Hyrje

Për gjëegjëzën do të mund të thonim se është pjesë e një pasurie universale botërore sepse së bashku me mitin, fabulat, përrallat dhe proverbat është njëri ndër llojet e mendimeve më të hershme të formuluar e të përhapura. Një përparësi e këtyre formave ndaj

krijimeve tjera gojore, e në mesin e tyre edhe e gjëegjëzës, janë karakteristikat esenciale si përbërje metaforike, si dhe e krahasimeve dhe përceptimeve të ngjashmërive dhe dallimeve. Dëshmi e lashtësisë së tyre është edhe prezenca e përhershme e elementeve si humori e mençuria në përmbajtjen e tyre. Gjëegjëzat hasen në një varg veprash antike, siç janë: *Rig Veda* e Indisë, *Besëlidhja e Vjetër*, disa *Saga Islandeze*, tablotë *Mesopotamiane*, *Talmudi* e *Kurani*, e kështu me radhë. Por, gjëegjëza, si njëra ndër format më të lashta, gjatë zhvillimit të saj evolutiv e ka ndërruar funksionin dhe karakterin që nga ai mitologjik, i riteve, i bastit e deri te ai i sotmi, që është në funksion të lojës e argëtimit kryesisht të fëmijëve me ndikim të theksuar estetik. Gjatë këtij ndërrimi të funksioneve, ndryshime ka pësuar edhe përmbajtja e gjëegjëzës, e cila është kushtëzuar edhe nga zhvillimi kulturor dhe nga vetitë e saja karakteristike siç janë përmbajtja e shkurtër dhe ritmi i theksuar.

Studimet mbi gjëegjëzën si formë e shkurtër e letërsisë gojore

Mbledhja dhe publikimi i gjëegjëzave të krijimtarisë sonë gojore u bë në radhë të parë nga ana e albanologëve të huaj, por një kontribut i madh për folkloristikën tonë është mbledhja dhe publikimi i materialeve nga ana e mbledhësve të hershëm, të cilët me këto materiale dëshmuar jo vetëm traditën e pasur kulturore e shpirtërore, por edhe aftësinë krijuese të popullit tonë. Në kuadër të këtyre materialeve, mbledhja dhe publikimi i gjëegjëzave në raport me ato të zhanreve të tjera nuk është i mjaftueshëm, por mbetet së paku të dëshmohet prezenca dhe lashtësia e këtij zhanri në krijimtarinë tonë gojore.

Gjithashtu, sa i përket edhe studimit të këtij zhanri përveç një parathënieje të një bleni siç është ai i Institutit të Folklorit “Gjegejeza”, Tiranë 1968 dhe të një punimi të studiueses Miranda Dule, *Roli i gjëegjézave në zhvillimin mendor të fëmijëve*, të botuar në “Nëntori” nr.1, Tiranë 1977, ose edhe ndonjë punimi për nevojat e teksteve shkollore, apo universitare, për gjëegjézën, si një zhanër i rëndësishëm i krijimtarisë gojore shqiptare, nuk është bërë aq sa duhet dhe aq sa është e nevojshme.

Ndërkaq, shumica e studiuesve botërorë që janë marrë me studimin e gjëegjézës, shpaleshin përkufizimet që ndjekin njëri tjetrin, duke filluar që nga ato më të hershmet, si ai i *Aristotelit*, i cili që atëherë thekson se gjëegjéza paraqet një përbërje metaforike, e gjer te hulumtimet e shumë studiuesve eminentë si *Hegeli*, i cili në leksionet e tija të njohura nga estetika, gjëegjézën e radhit së bashku me alegorinë dhe metaforën si “*simbolikë të vetëdijshme*”. Poashtu edhe *Andre Jolles*, në studimin e tij *Format e thjeshta*, i veçoi karakteristikat e gjëegjézës duke e ndarë atë në një formë më vete. Një vëmendje të veçantë gjëegjézës i kushtoi edhe studiuesi i njohur amerikan *Archer Taylor*, i njohur ndër studiuesit e krijimtarisë gojore si themelues i studimeve folkloristike, i cili njëkohësisht i vuri edhe bazat e studimeve anglo-amerikane për gjëegjézën. Por edhe një varg studiuesish të tjerë që vazhduan pas *Taylor-it*, si *Alan Dundes*, *Robert A. Georges*, *Roger D. Abrahams*, *Jan H. Brunvand*, *Elli Köngäs-Maranda*, *Dan Ben-Amos*, *W. J. Pepicello*, *Th. A. Green*, *A. Kaivola-Bregenhøj*, etj., si dhe studiues të rajonit, po ashtu edhe studiues të krijimtarisë sonë gojore, konstatojnë se gjëegjéza është një zhanër artistikisht i pasur dhe mjaft prezent në krijimtarinë gojore të shumë kulturave, me një ecuri të ngjashme funksionale, formësore e përmbajtësore. Ngjashmëria mund të jetë për nga natyra, për nga elementet e njëjta të objekteve, por edhe për nga mjetet figurative, pas të cilave fshihet objekti i kërkuar. E përbashkëta e këtyre studimeve mbetet ajo që gjëegjéza është mikrostrukturë dhe pjesë përbërëse e formave të shkurtra, të vogla ose minore. Shembujt në vijim nga përmbledhja e gjëegjézave angleze të *Taylor-it* dhe nga krijimtaria jonë gojore janë dëshmi e kësaj ngjajshmërie:

- **varianti i gjëegjézës angleze:** What goes to the branch and drinks and don't drink? (*cow and bell*) (Çka shkon në degë të lumit, pin dhe nuk pin?) (*lopa dhe zilja*)

- **varianti i gjëegjézës shqipe:** Shkon me pi ujë, / vjen pa pi ujë. (*zilja e bagëtisë*)

Në raste të këtyra sipas *Sydow-it* mund të flitet për të ashtuquajturat *oikotipe* të cilat edhe pse i takojnë

kulturës së përgjithshme, i marrin veçoritë e krijimtarisë gojore të kulturës përkatëse.

Kjo formë e shkurtër, e përbërë nga pyetja dhe përgjigjja, e konceptuar në formë dialogu, me një shprehje të dykuptimshme e bën gjëegjézën të jetë shumë dinamike. Përshkrimi i një objekti në mënyrë të tërthortë, duke i veçuar disa karakteristika të objektit në fjalë, qofshin ato të veçanta ose të përgjithshme, bën që e panjohura në gjëegjézë të formohet me anë të shenjave të ngjashme ose të antipodeve dhe e dallon atë nga format tjera të shkurtra mu për faktin se paraqet një përshkrim metaforik të atij objekti apo të asaj dukurie.

Perspektiva e studimit të gjëegjézës

Po që se e vlerësojmë si të mbyllur ciklin e krijimit të gjëegjézave brenda krijimtarisë letrare gojore, atëherë në perspektivë studimin e këtij zhanri do të duhej t'a përqëndrojmë në ndikimin e gjëegjézës gojore, në atë të krijimtarisë letrare të shkruar, duke mbetur kështu në vazhdimësi në funksionin e saj pedagogjik e argëtues të fëmijëve, por edhe në rolin edukativ të saj. Që në hyrje të kësaj kumtese kam cekur se qytetërimet e ndryshme e kanë parë dhe vlerësuar nevojën e funksionimit të gjëegjézave. Prandaj gjëegjézat i hasim në veprat e shkruara që nga kohrat e lashta e gjer më sot. Gjëegjézat në kohrat antike, janë përdorur për zhvillimin e mprehtësisë mendore dhe për këtë arsye edhe kanë qenë prezente në rituale e festa të ndryshme. Ky zhanër i lashtë i krijimtarisë gojore, gjatë funksioneve të shumta që ka pasur, ka vazhduar që në kontinuitet ta ruajë funksionin edukativ, që me anë të gjëegjézave t'i zgjerojë njohuritë sa më të plota e të gjithanshme për realitetin. Ky zhanër kërkon të vërtetën në natyrë e shoqëri, ndërsa në mendimin njerëzor sjell një informacion të pasur nga shumë sfera të jetës. Prandaj, duke humbur funksionin e saj mitik e të ritualit, gjëegjéza mbetet në funksion të nxitjes dhe matjes logjike të zgjuarësisë, por gjithmonë me karakter argëtues dhe të lojës kryesisht në raport me fëmijët.

Dihet se letërsia gojore në vete bart kompleksitetin e vet, që rezulton nga sistemi i saj artistik shumë shtresor dhe nga domosdoshmëria për një qasje ndaj vlerave të saja sipas metodave që praktikohen edhe në studimin e veprave të letërsisë së shkruar. Nëse gjatë një analize të këtyre fitohet bindja për dimensionet e njëmendëta artistike të krijimeve gojore, atëherë edhe secili autor, si krijues i një hartimi poetik të shkruar, mund të jetë në rolin e huazuesit, të marrësit, apo të imituesit të këtyre vlerave. Prandaj, si shumë zhanre të krijimtarisë gojore edhe gjëegjéza i ka përkimet e saja me atë të letërsisë së shkruar.

Sipas këtij studiuesi, gjëegjëzat e kultivuara për fëmijët dalin si dy modalitete strukturale:

1. Sipas modalitetit tradicional fëmijët duhet ta zbërthejnë enigmën e klishetizuar që ndikon në zhvillimin mendor të fëmijëve, në shkathësinë e tyre intelektuale, në gjykimet dhe vendosjen e raporteve midis sendeve e fenomeneve dhe të arrihet madhështia dhe bukuria e gjëegjëzave, nëpërmjet të së cilave, siç shprehet edhe Bedri Dedja, “të pasqyrohet mençuria dhe urtësia e popullit tonë.” (Dedja,1971:47)

2. Modaliteti i ri i gjëegjëzave, i transponuar artistikisht prej poetëve të huaj dhe poetëve tanë, sipas modelit të gjëegjëzave gojore, krijuan grupin më selektiv të poezisë botërore për fëmijë. Pra, “derisa enigma tradicionale është e paralajmëruar te fëmijët dhe zbërthehet prej të vegjëlve, ku sqarimi gradual jep sekretin, në vjershat e tipit enigmatik fëmija nuk paralajmërohet se ka të bëjë me enigmën, por ai do ta kuptojë këtë pasi ta lexojë një sfond vargësh. Kjo bën që ai të hyjë spontanisht në një labirinth të vogël, ku sqarimi gradual bëhet paralelisht me sqarimin subjektor të motivit dhe si rezultat i tërë këtij procesi është transponimi artistik, i cili pas zbërthimit të sekretit jep befasinë e lexuesit të vogël, që përmes një kulture psikike të karakterit katarzoik, manifeston momente të theksuara emocionale.” (Deva,1982:112)

Prandaj, kjo studiuese gjëegjëzat i ndan në tri grupe:

a. në gjëegjëza që ngrihen mbi ngjashmërinë e tipareve të jashtme të sendeve e fenomeneve; pra mbi dhënien e ngjyrave të sendit. P.sh. **I bardhë, i bardhë si kokërr dardhe, i zi, i zi si kokërr ulli (syri);**

b. në gjëegjëza që paraqesin tipare të brendshme të sendeve dhe fenomeneve; gjëegjëzat që ngrihen mbi disa tipare të ngjashme në formë. P.sh.: **Hollë, hollë si byrek, trashë, trashë si çyrek (libri)** dhe

c. në gjëegjëza problemore që paraqesin sendin nëpërmjet zhurmës, tingujve, që ndryshe quhen gjëegjëza onomatopeike. P.sh.: **Vizh-viz e fup mes dere (fshesa)** ose **Sipri suprap xhami rapatap (tezgjahu).**

Në zhvillimin mendor të fëmijëve të një moshe më të rritur, rol të rëndësishëm luajnë edhe të ashtuquajturat gjëegjëza problemore nga sfera e matematikës që janë mjaft tërheqëse për fëmijët sepse formojnë dhe edukojnë durimin, këmbënguljen, shkathësinë e të menduarit dhe arsytimin. Në këto gjëegjëza kërkohet një e panjohur, që gjendet nëpërmjet një abstrakcioni logjik të një shkalle të lartë, nëpërmjet arsytimeve mjaft të ndërlikuara. Prandaj këto gjëegjëza u përshtaten fëmijëve të një moshe më të rritur. (Dule,1977:214)

Edhe krijuesi më produktiv i letërsisë së shkruar për fëmijë, Odhise K. Grillo, njëkohësisht edhe një njohës i

dalluar i psikologjisë dhe i fuqive mendore të fëmijëve, vlerën poetike të gjëegjëzave e sheh jo vetëm në vargëzimin e mendimit të saj, duke i fshehur veçoritë e objektit, dukurisë apo sendit, por edhe në gjuhën poetike dhe në mjetet e saja shprehëse. Në këtë mënyrë gjëegjëza bëhet më e afërt dhe më e dashur për lexuesin apo dëgjuesin e vogël.

Prandaj, nga kjo që cekëm më lart, lidhur me vlerën, begatinë, llojllojshmërinë dhe mbi të gjitha, rolin edukativ e mësimor, si të gjëegjëzave të krijimtarisë gojore, ashtu edhe të gjëegjëzave të letërsisë së shkruar dhe të dedikuar fëmijëve, do të shtonim se absorbimi i gjëegjëzave nga krijimtaria gojore dhe kombinimi i efekteve të tyre në një poezi të re artistike nuk është bërë pa vështësi. “Kjo dëshmon se edhe gjëegjëzat, sado që në të parë duken krijime të thjeshta, i kanë finesat e veta, janë delikate për t’u krijuar dhe kërkojnë mjeshtri të veçantë për t’u transferuar më tej, nëpër modalitete të ndryshme të të kënduarit.” (Deva,1982:114)

Në kuadër të letërsisë së shkruar për fëmijë kemi një numër të konsiderueshëm të botimeve me gjëegjëza, por jo të mjaftueshme, të pasuruara edhe me ilustrime për secilën gjëegjëzë të dhënë, që është një ndihmesë për fëmijët parashkollorë. Fëmijët i duan gjëegjëzat dhe me kërshtëri të madhe mundohen që të garojnë në mes tyre se cili do ta gjejë përgjigjen sa më parë. Prandaj në botën fëmijërore gjëegjëza vazhdon të jetë prezente duke zhvilluar funksionin e saj pedagogjik e të argëtimit dhe këtu qëndron perspektiva e studimit të kësaj forme të shkurtër.

Bibliografia

- DEVA, Dr. Agim (1982), *Poezia shqipe për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë.
- DULE, Miranda (1977), *Roli i gjëegjëzave në zhvillimin mendor të fëmijëve*, “Nëntori”, Tiranë, nr.1.
- USHT, IF, FSh (1968), *Gjëegjëza*, Tiranë.
- WILHELM, von Sydow Carl (1977), *Selected Papers on Folklore*, New York.